



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Duke u mbështetur në dispozitat e nenit 4, paragrafi 6 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe nenit 12 të Statutit të Qendrës së Mjekësisë Urgjente, Komuna e Prishtinës, shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Titulli i punës: Drejtor i Qendrës së Mjekësisë Urgjente

Niveli i pagës/koeficienti : 12

Orari i punës: I plotë

Drejtori i QMU – se për punën e vet raporton Drejtorit të DSHMS-së të Komunës së Prishtinës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Organizon, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e QMU-së;
- Propozon politikat e zhvillimit të Qendrës dhe politikat për mbështetje financiare;
- Organizon, mbikëqyr dhe motivon punën e personelit dhe jep udhëzime dhe urdhëresa për punë;
- Paraqet raportet përkatëse për rezultatet e punës, ecurinë e punës së shërbimeve dhe përdorimin e buxhetit përmes DSHMS-së;
- Përcjell problematikën e punës në Qendër dhe merr masa për zgjidhje me të mira;
- Drejtori i QMU-së për kryerjen e punëve të tij i përgjigjet drejtorit të DSHMS – së dhe Kryetarit të Komunës;
- Koordinon punët me qëllim të shpërndarjes racionale dhe proporcionale të punëve në QMU;
- Raporton pranë drejtorit të DShMS-së në baza periodike për punën e QMU;
- Koordinon zbatimin e vendimeve të drejtorit të DShMS-së dhe qarkullimin e raporteve;
- Bashkëpunon me institucionet të tjera shëndetësore sipas udhëzimeve të drejtorit të DShMS-së, lidhur me aktivitetet e ndryshme që ndërlidhen me çështjet shëndetësore;
- Pranon dhe përgjigjet në korrespondencën elektronike prej Organizatave dhe Institucioneve Ndërkombëtare dhe Vendore;
- Ushtron edhe detyra e autorizime dhe mban përgjegjësi të tjera në përputhje me aktin, dispozitat ligjore dhe aktet tjera që kanë të bëjnë me mjekësinë urgjente.

Kualifikimi dhe përvoja:

- Aftësi të plotë për përmbushjen e detyrave nga vendi i punës, me orar të plotë pa kufizime dhe pengesa ligjore,
- Përgatitja universitare: Fakulteti i Mjekësisë – Specialistë i Mjekësisë Familjare apo Emergjencës,
- Ti ketë së paku 3 vite përvojë pune në mjekësinë familjare apo emergjente
- Ti ketë së paku 1 vit përvojë pune nga fusha e menaxhimit dhe zbatimit të mjekësisë familjare apo emergjente,
- Aftësi të mira analitike dhe komunikuese,
- Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme,
- Njohuri të punës me kompjuter , me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Outlook, internet).
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve të vështira me ngarkesë,
- Aftësi të tjera që shërbejnë për kryerjen e detyrave të punës dhe raportet kolegjiale në marrëdhënie të punës.

Data e shpalljes së Konkursit 18.05.2018 deri me dt. 01.06.2018**Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:**

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Burimeve Njerëzore në nr.e tel: 038/230-900, lok. 10-70, apo Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me nr.tel.230-900, lok.11-87, prej orës 08:00 – 16:00 me adresë Komuna e Prishtinës, Rruga UÇK nr. 2, Prishtinë – Republika e Kosovës. Konkursi është i hapur **15** ditë nga dita e publikimit në selinë e organit të punësimit. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune, për të cilin konkurrenca.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Me shpalljen e këtij konkursi, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale pranë Komunës së Prishtinës ofron mundësitë e barabarta të punësimit për të gjithë punëtorët e Qendrës së Mjekësisë Urgjente.